



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 9 Mars 2022

Nr: 133

VENDIM

PËR

**DHËNIEN E MANDATIT TË KRYETARIT TË BASHKISË RROGOZHINË, QARKU
TIRANË, Z. EDISON SELMAN MEMOLLA, PËR ZGJEDHJET E PJESSHME PËR
KRYETAR BASHKIE TË DATËS 6 MARS 2022**

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronja “i”, e 2, 33, shkronja “g” dhe 166, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

V Ë R E N:

Në mbështetje të Dekretit nr. 13438, datë 20.01.2022, të Presidentit të Republikës, “Për caktimin e datës së zgjedhjeve të pjesshme vendore për kryetar bashkie për disa njësi të qeverisjes vendore”, në bashkinë Rrogozhinë, u zhvilluan zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie.

Bazuar në nenin 166, pika 1, të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, kryetar bashkie zgjidhet kandidati që fiton numrin më të madh të votave të vlefshme të zgjedhësve që kanë votuar në njësinë vendore përkatëse.

Bazuar në nenin 33, shkronja “g”, Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor nr. 43, me vendimin nr. 232, datë 7.3.2022, ka shpallur fitues për zgjedhjet e pjesshme për Kryetar Bashkie të Bashkisë Rrogozhinë, z. Edison Selman Memolla, propozuar nga “Partia Socialiste e Shqipërisë”.

Nga kontrolli i dokumentacionit u vu re se, në Tabelën Përmbledhëse të Rezultateve të Bashkisë Rrogozhinë, qarku Tiranë, janë pasqyruar rezultatet e të gjitha Qendrave të Votimit.



PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja “i”, e 2, 33, shkronja “g” dhe 166, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

VENDOSI:

1. Dhënien e mandatit të Kryetarit të Bashkisë Rrogozhinë, qarku Tiranë, z. Edison Selman Memolla, të propozuar nga “Partia Socialiste e Shqipërisë”.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 24 (njëzet e katër) orëve nga shpallja e tij, në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Illirjan CELIBASHI

